

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
KOMUNËN QENDËR, LIBRAZHD

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Komunën Qendër, Librazhd**, me objekt: *“Mbi vlerësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, aktivitetit ekonomik e financiar, prokurimet me fondet publike, taksat dhe tarifat vendore, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimin e aseteve, dhënien me qira të objekteve pronë publike, etj”*, lloji i auditimit: *“Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”*, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2011 deri 31.12.2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 54, datë 30.05.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 *“Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”*, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 308/7, datë 30.5.2014, i ka rekomanduar z. Enver Shkurti Kryetar i Komunës, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga Komuna të merren masa për zbatimin e rekomandimeve të lëna në Auditimin e mëparshëm dhe të pa zbatuara për arkëtimin e shumës **2,730,800 lekë nga 11 subjekte.**

Menjëherë

2. Të merren masa, për implementimin e kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*;

-të përpilohet rregullorja e funksionimit të brendshëm;

-të ngrihet Grupi i Menaxhimit Strategjik;

-të emërohet koordinatori i riskut dhe të merren masat për menaxhimin e tij.

Brenda muajit Shtator 2014

3. Të merren masat e nevojshme për zbatimin e buxhetit sipas kërkesave ligjore, konkretisht:

-të ndalohen praktikat e kryerjes së shpenzimeve ndërtimore për mirëmbajtje të rrugëve, rikonstrukcion të godinave riparime etj., në mungesë të projekteve dhe preventivat përkatëse, çka është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 *“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”*, i ndryshuar, nenet 3 dhe 4.

-të ndalohen praktikat e kryerjes të një zë punimi ndërtimor në disa kontrata, duke shmangur kufirin monetar për kryerjen me procedurën e tenderimit, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 *“Për rregullat e prokurimit publik”*, i ndryshuar, kreu II, pikat 1/b dhe 1/c.

Menjëherë

4. Nga Komuna, të merren masat e nevojshme për regjistrimin e aseteve në ZVRPP, të cilat me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 804, datë 4.6.2008 *“Për miratimin e listës përfundimtare të pronave pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Qendër Librazhd, të Qarkut Elbasan”*, janë miratuar në pronësi të Komunës Qendër Librazhd, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 *“Për pronat e paluajtshme të shtetit”* i ndryshuar, neni 8 dhe VKM nr. 500 datë 14.08.2001 *“Për*

inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore.

Brenda muajit Tetor 2014

5. Nga Zyra e Taksave e Tarifave Vendore, të ndiqen hapat ligjore në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr. 10415, datë 07.04.2011, neni 41 me qëllim:

-arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore për 27 subjekte në vlerën 793,815 lekë;

-llogaritjen dhe arkëtimin e detyrimeve për kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore në zbatim të ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për 8 subjekte për vlerën prej 1,053,888 lekë.

Menjëherë

6. Nga Zyra e Taksave e Tarifave Vendore në bashkëpunim me Zyrën e Financës dhe Policinë e Komunës, të merren masa për arkëtimin e debitorëve të pa likuiduara deri më datën 31.12.2013 për të 3 llojet e taksave e tarifave të popullatës në vlerën 6,353,000 lekë, përkatësisht: për taksën e tokës, në vlerën 2,315,000 lekë, taksa e banesave në vlerën 544,000 lekë dhe tarifë pyjore në vlerën 3,494,000 lekë.

Vazhdimisht

7. Nga Zyra e Taksave e Tarifave Vendore në bashkëpunim me Zyrën e Financës dhe Policinë e Komunës, të merren masa, në zbatim të procedurave ligjore, për arkëtimin e vlerës 1,361,657 lekë nga 16 subjekte debitorë të biznesit të vogël si dhe të kërkohej në rrugë ligjore arkëtimi i gjobës në masën 25 për qind të detyrimit të pa paguar në afate ligjore nga 15 subjekte në vlerën 245,125 lekë, gjithsej 1,606,782 lekë.

Vazhdimisht

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Nga komuna të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohej në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim për shpërblimin e dëmit me **vlerën 2,864,467 lekë**, në mënyrë analitike si më poshtë:

1. Për vlerën **855,000 lekë**, nga 36 subjekte taksa pages, për mospagesën e taksës së biznesit të vogël, nga mos regjistrimi i tyre për veprimtari transporti.

Brenda muajit Tetor 2014

2. Për vlerën **669,562 lekë**, për sa z. E.Sh., ka urdhëruar pagesën për subjektin "L..." shpk 5% e vlerës së garancisë së punimeve për objektin: "Rikonstruksion Ujësjiellësi në Fshatin Kutërman", në kundërshtim me kap. II, pikën 10, të UKM nr. 3, datë 15.2.2011 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar.

Menjëherë

3. Për vlerën **598,524 lekë**, paguar subjekti "Vëllezërit H..." shpk për volume pune të pa kryera në objektin: "Rikonstruksion i rrugës Kutërman", në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8402, datë 1.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, neni 7 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", pika 17.

Menjëherë

4. Për vlerën **300,000 lekë**, shpenzime për çbllokimin e rrugëve nga dëborat, pa pasur dokumentacionin e nevojshëm justifikues, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar dhe pikat 35/a, 35/b të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik";

- z. E.SH. për 100,000 lekë;
- z. I.Gj. për 100,000 lekë;
- Subjekti N.D. për 100,000 lekë.

Brenda muajit Tetor 2014

5. Për vlerën **120,000 lekë**, ka përfituar shpenzime telefon celulari titullari i komunës z. E.SH., në kundërshtim me kërkesat pikat 9, 14 dhe 15 të VKM nr. 864, datë 23.7.2010 "Për vajtjen me numër celulari të personave juridikë publikë".

Brenda muajit Tetor 2014

6. Për vlerën **67,500 lekë**, përfituar shpenzime për udhëtime e dieta, në kundërshtim me kërkesat e kap. III, pika 1 të VKM nr. 997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", i ndryshuar;

- z. E.SH. për 52,500 lekë;
- SH.K. për 10,000 lekë;
- SH.D. për 5,000 lekë.

Brenda muajit Tetor 2014

7. Për vlerën **66,500 lekë**, janë bërë dalje materiale në përfitim të tretëve, në kundërshtim me kërkesat e neneve 3 pika 9, neni 40 dhe neni 71/a të ligjit nr. 9936, datë 26.8.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor", i ndryshuar dhe kap. I, neni 3, kap. III, neni 7, kap. IV, neni 10 të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar;

- z. L.H. për 33,250 lekë;
- z. SH.K. për 33,250 lekë.

Brenda muajit Tetor 2014

8. Për vlerën **55,776 lekë**, për sa është llogaritur më pak se manuali, fondi limit në tenderin me objekt: "Rikonstruksion i rrugëve rurale të Komunës për vitin 2013", në kundërshtim me kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar neni 28 dhe VKM nr. 1, datë 10.1.2007 "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, kreu II, pika 2;

- z. I.M. për 18,592 lekë;
- z. Y.B.i për 18,592 lekë;
- z. B.M. për 18,592 lekë.

Brenda muajit Tetor 2014

9. Për vlerën **47,289 lekë**, për sa është paguar subjekti "Rest...G...-K..." shpk 5% e vlerës së garancisë së punimeve rikonstruksion të shkollave, në kundërshtim me kërkesat e kap. II, neni 6 të UKM nr. 3, datë 15.2.2011 "Mbikëqyrja dhe kolaudimi i punimeve të ndërtimit", i ndryshuar.

Menjëherë

10. Për vlerën **34,500 lekë**, për sa kanë përfituar nga komuna, matës hidraulikë 23 abonentë familjarë, në kundërshtim me kërkesat kap II, pika 3 të Udhëzimit të MPPTT nr. 3, datë 28.7.2004 "Për administrimin e ujit të pijshëm".

Brenda muajit Shtator 2014

11. Për vlerën **25,216 lekë**, përfituar z. Shpëtim Dosku pagë për lejen e zakonshme të pa kryer të vitit 2012, në kundërshtim nenin 40, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", neni 93, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Për kodi i punës në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, si dhe UMF nr. 1/1, datë 19.2.2013 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2013".

Brenda muajit Tetor 2014

12. Për vlerën **18,600 lekë**, përfituar më tepër shpërblim anëtar i Këshillit të Komunës z.S.A., për periudhën datë 1.1.2012 deri më datën 31.12.2013, pasi nuk është llogaritur dhe ndalur tatimi mbi shpërblimin, në kundërshtim me neni 9, pika 2, të ligjit 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimi mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Brenda muajit Tetor 2014

13. Për vlerën **6,000 lekë**, për sa nuk janë paguar detyrimet nga z. E.M. për objektin dhënë me qira nga Komuna Qendër Librazhd, sipas kontratës të lidhur midis palëve datë 11.10.2011.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

-Mbështetur në kreun IV, neni 11, germa “e” dhe “ç” dhe nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe kontratës individuale tip, i rekomandojmë Kryetarit të Komunës, fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore:

“Ndërprerje të marrëdhënieve të punës”

1. Z. SH.K. me detyrë përgjegjës i Zyrës së Financës.

-Për mosndjekjen e procedurave ligjore për arkëtimin e detyrimeve debitorë për 11 subjekte në shumën 2,730,800 lekë, të rekomanduara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 187/10 prot., datë 26.3.2008.

-Për mos programim në buxhetin e vitit 2013, fonde për mbështetjen e pemëtarie dhe gjelbërimit nga transferta e pa kushtëzuar jo më pak se 10% e saj, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 2, datë 6.2.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit 2012" dhe UMF nr. 1/1, datë 19.2.2013 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2013".

-Për sa nuk është llogaritur dhe ndalur tatim mbi shpërblimin për anëtarin e Këshillit të Komunës z. S.A., në kundërshtim me neni 9, pika 2, të ligjit 8438, datë 28.12.1998 "Tatimi mbi të Ardhurat" me ndryshime.

-Për sa në vitin 2013, në 1 rast është kryer pagesë për lejen e zakonshme të pa kryer në vitin paraardhës, në kundërshtim nenin 40, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSh", neni 93, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i punës në RSh" i ndryshuar, si dhe UMF nr. 1/1, datë 19.2.2013 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2013".

-Për sa janë paguar shpenzime për udhëtime e dieta për 3 persona në shumën 67,500 lekë, në kundërshtim me kërkesat e kap. III, pika 1 të VKM nr. 997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", i ndryshuar.

-Për sa është paguar subjekti "F...Oil" shpk për blerje karburanti Eurodizel D1 gjithsej për shumën 4,598,410 lekë, pa pasur certifikatën e cilësisë së karburantit, në kundërshtim me kërkesat e kontratës së lidhur midis palëve datë 9.4.2012 dhe datë 4.4.2013, neni 7 dhe pika 54 e UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

-Për sa në 2 raste për vlerën 635,326 lekë, janë kryer shpenzime për blerje materiale në shkelje të procedurave të prokurimit, neni 3, 4 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", VKM nr. 1 datë 10.1.2007 "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar pika 6 e Udhëzimit të APP-së nr. 2, datë 18.2.2008 "Për procedurat e prokurimit me vlera të vogla", kap. III, pikat 44 dhe 47 e UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

-Për sa janë paguar për dhënie bursa për studentët nga të ardhurat lokale në shumën 640,000 lekë, në kundërshtim me kërkesat e kap. I, neni 3, kap. III, neni 7, kap. IV, neni 10 të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar dhe neni 1 të VKM nr. 545, datë 16.8.2012 "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, bursat e shtetit dhe pagesat e nxënësve e të studentëve në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2012-2013".

-Për sa ka autorizuar daljet nga magazina të materialeve për riparime dhe shërbime në shumën totale 1,711,750 lekë, pa dokumentacionin e nevojshëm justifikues, në kundërshtim

me kërkesat e kap. III, pikat 34, 35/b të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

-Për sa nuk ka evidentuar konsumin e karburantit për dy auto veturat e komunës sipas normativave të miratuara me komision, në kundërshtim me kërkesat e kap. III, pikat 34, 35/b të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

2. Zj. L.S. me detyrë përgjegjëse e Zyrës Juridike.

-Për mosndjekjen e procedurave ligjore për arkëtimin e detyrimeve debitor për 11 subjekte në shumën 2,730,800 lekë, të rekomanduara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 187/10 prot., datë 26.3.2008.

-Për sa ka iniciuar në 5 raste për 10 persona në shumën 700,000 lekë, shpenzime nga të ardhurat lokale, ndihma financiare në raste sëmundjesh, në shkelje të kërkesave të kap. I, neni 3, kap. III, neni 7, kap. IV, neni 10 të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar.

-Për sa ka iniciuar vendimin në Këshillin e Komunës për dhënie bursa për studentët nga të ardhurat lokale në shumën 640,000 lekë, në kundërshtim me kërkesat e kap. I, neni 3, kap. III, neni 7, kap. IV, neni 10 të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar dhe neni 1 të VKM nr. 545, datë 16.8.2012 "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, bursat e shtetit dhe pagesat e nxënësve e të studentëve në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2012-2013".

-Për shkeljet e konstatuara ne tenderin: "Rikonstruksion i rrugëve rurale të komunës për vitin 2012", në cilësinë anëtarit të komisionit të hartuesit të dokumenteve. Në dosjen e tenderit nuk gjenden procesverbale të komisionit të hartueseve të dokumenteve të tenderit për mënyrën se si është llogaritur fondi limit. Dokumentacioni i arkivuar i subjektit fitues, është fotokopje e pa noterizuar, në kundërshtim me kërkesat e nenit 12 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe pikën 2/c të Kreu-t III Dokumentet e tenderit të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 "Për rregullat e prokurimit publik".

-Për shkeljet e konstatuara ne tenderin: "Rikonstruksion i rrugëve rurale të komunës për vitin 2013", në cilësinë anëtarit të komisionit të hartuesit të dokumenteve. Në dosjen e tenderit nuk gjenden procesverbale të komisionit të hartueseve të dokumenteve të tenderit për mënyrën se si është llogaritur e fondi limit, në kundërshtim me kërkesat e nenit 12 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe pikën 2/c të Kreu-t III Dokumentet e tenderit të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 "Për rregullat e prokurimit publik".

3. Z. Y.B. me detyrë përgjegjëse i Zyrës së Tatim Taksave.

-Për shkeljet e konstatuara ne tenderin: "Rikonstruksion i rrugëve rurale të komunës për vitin 2012", në cilësinë anëtarit të komisionit të hartuesit të dokumenteve. Në dosjen e tenderit nuk gjenden procesverbale të komisionit të hartueseve të dokumenteve të tenderit për mënyrën se si është llogaritur e fondi limit. Dokumentacioni i arkivuar i subjektit fitues, është fotokopje e pa noterizuar, në kundërshtim me kërkesat e nenit 12 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe pikën 2/c të Kreu-t III Dokumentet e tenderit të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 "Për rregullat e prokurimit publik".

-Për shkeljet e konstatuara ne tenderin: "Rikonstruksion i rrugëve rurale të komunës për vitin 2013", në cilësinë anëtarit të komisionit të hartuesit të dokumenteve. Në dosjen e tenderit nuk gjenden procesverbale të komisionit të hartueseve të dokumenteve të tenderit për mënyrën se si është llogaritur e fondi limit, në kundërshtim me kërkesat e nenit 12 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe pikën 2/c të Kreu-t III Dokumentet e tenderit të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 "Për rregullat e prokurimit publik".

-Për mos vjeljen e të ardhurave nga taksa e biznesit të vogël në shumën 855,000 lekë prej 36 subjektet të paregjistruar në QKR si person fizik e juridik dhe të pajisur me certifikatë transporti nga Komuna dhe mos zbatimi i procedurave për vjeljen e të ardhurave lokale, në kundërshtim me kërkesat e ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, ndryshuar me ligjin nr. 9745,

datë 28.05.2007 "Për sistemin e taksave vendore", udhëzimi i Ministrisë Financave dhe Ministrisë Brendshme nr. 655/1, datë 06.02.2007, si dhe ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore " me ndryshime.

Vërejtje me paralajmërim për larqim nga puna"

1. I.Gj. me detyrë ish përgjegjës i Zyrës së Financës për periudhën deri në mars të vitit 2012 dhe më pas me detyrën e Inspektorit të Tatim Taksave.

-Për mos programim në buxhetin e vitit 2012, fonde për mbështetjen e pemëtarie dhe gjelbërimit nga transfertat e pa kushtëzuar jo më pak se 10% e saj, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 2, datë 6.2.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit 2012" dhe UMF nr. 1/1, datë 19.2.2013 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2013".

-Për sa nuk është llogaritur dhe ndalur tatim mbi shpërblimin për anëtarin e Këshillit të Komunës z. Skënder Alla, në kundërshtim me neni 9, pika 2, të ligjit 8438, datë 28.12.1998 "Tatimi mbi të Ardhurat" me ndryshime.

-Për sa është paguar subjekti N.D. për shumën 300,000 lekë, pa pasur dokumentacionin e nevojshëm justifikues, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar dhe pikat 35/a, 35/b të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

-Për mos vjeljen e të ardhurave nga taksa e biznesit të vogël në shumën 855,000 lekë prej 36 subjektet të përgjigjshëm në QKR si person fizik e juridik dhe të pajisur me certifikatë transporti nga Komuna dhe mos zbatimi i procedurave për vjeljen e të ardhurave lokale, në kundërshtim me kërkesat e ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 ndryshuar me ligjin nr. 9745, datë 28.05.2007 "Për sistemin e taksave vendore", udhëzimi i Ministrisë Financave dhe Ministrisë Brendshme nr. 655/1, datë 06.02.2007, si dhe ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore" me ndryshime.

2. B.M. me detyrë përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës.

-Për shkeljet e konstatuara ne tenderin: "Rikonstruksion i rrugëve rurale të komunës për vitin 2012", në cilësinë anëtarit të komisionit të hartuesit të dokumenteve. Në dosjen e tenderit nuk gjenden procesverbale të komisionit të hartueseve të dokumenteve të tenderit për mënyrën se si është llogaritur e fondi limit. Dokumentacioni i arkivuar i subjektit fitues, është fotokopje e pa noterizuar, në kundërshtim me kërkesat e nenit 12 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe pikën 2/c të Kreu-t III Dokumentet e tenderit të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 "Për rregullat e prokurimit publik".

-Për shkeljet e konstatuara ne tenderin: "Rikonstruksion i rrugëve rurale të komunës për vitin 2013", në cilësinë anëtarit të komisionit të hartuesit të dokumenteve. Në dosjen e tenderit nuk gjenden procesverbale të komisionit të hartueseve të dokumenteve të tenderit për mënyrën se si është llogaritur e fondi limit, në kundërshtim me kërkesat e nenit 12 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe pikën 2/c të Kreu-t III Dokumentet e tenderit të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 "Për rregullat e prokurimit publik".

3-E.A. me detyrë Inspektor i Mjedisit, Ujërave Pyjeve dhe Kullotave.

-Për sa nuk ka iniciuar dhënien me qira të sipërfaqes prej 6803 ha fond pyjor dhe kullosor, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i ndryshuar, kreu IV, neni 19, ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007: "Për Fondin kullosor", i ndryshuar, neni 18, VKM nr. 22, datë 9.01.2008 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kritereve të administrimit të pyllit komunal", pikat 6, 7, 10.

4. V.B. me detyrë përgjegjës i ZMMT-së (Zyra e mbrojtjes dhe menaxhimit të tokës).

-Për sa nuk ka iniciuar dhënia me qira e sipërfaqes së tokës bujqësore të pa ndarë prej 938 ha, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8312, datë 26.3.1998 "Për tokat bujqësore të pa ndara", neni 5, VKM nr. 531, datë 21.8.1998 "Për tokat bujqësore të pa ndara", i ndryshuar me VKM nr. 176, datë 30.3.2011, pika 4, Udhëzimit të e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit Mbrojtjes së Konsumatorit dhe të Ministrit të Brendshëm Nr. 3, datë 16.5.2007 "Për

procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pa ndara", paragrafit I, pika 1 dhe UKM nr. 1, datë 18.7.2012 "Për procedurat e dhënies me qira të tokës bujqësore të pa ndarë", (udhëzim i cili ka shfuqizuar Udhëzimin nr. 3, datë 16.5.2007) paragrafi I, pika 3.

5. G.B. me detyrë Përgjegjës i Inspektorit Urbanistik Ndërtimor Urbanistik Vendor.

-Për mos veprim sipas kërkesave ligjore për 60 raste të ndërtimeve pa leje në territorin e Komunës, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektoratin ndërtimor", i ndryshuar, neni 5, 12 dhe 13 dhe VKM 862, datë 5.12.2007 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar e ai vendor" pikat 4, 6 dhe 5.

6. SH.G. me detyrë përgjegjës i policë së komunës.

-Për mungesë të programeve lidhur me mbrojtjen e ambientit, kontrollin mbi mbjelljen e bimëve narkotike, të planet dy javore të aktivitetit të policisë si dhe planet e shërbimit për çdo rast, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997, nenet 15, 35.

D. MASA ADMINISTRATIVE

Nga auditimi i ushtruar në Komunën Qendër Librazhd, u konstatuan mangësi dhe shkelje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik".

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit" i ndryshuar, ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative" neni 7, pika 2, 3/a, ti rekomandojmë Agjencisë së Prokurimit Publik, që:

Në zbatim të nenit 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik" i ndryshuar, Kreu X, të shqyrtojë dhe të marrë masa disiplinore ndaj anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave:

1. L.S., aktualisht me detyrë përgjegjëse e Zyrës Juridike.

2. B.M., aktualisht me detyrë përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës.

3. Y.B., me detyrë përgjegjës i Zyrës së Tatim Taksave.

-Për shkelje të rregullave të prokurimit publik, në tenderin me objekt: "Rikonstruksion i rrugëve rurale të komunës për vitin 2012", zhvilluar në vitin 2012.

Në dosjen e tenderit, nuk gjendet procès-verbali i komisionit të hartueseve të tenderit për mënyrën se si është llogaritur fondi limit, në kundërshtim me kërkesat e nenit 12 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe pikën 2/c të Kreu III "Dokumentet e tenderit" të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar.

Nuk janë respektuar afatet e njoftimit të tenderit. Njoftimi i publikuar në APP, është bërë në buletin e datës 10.9.2012, pra ditën që është zhvilluar tenderi. Në arkivin elektronike, njoftimi i shpalljes së tenderit, është bërë datë 31.8.2012, i cili është i pa lexueshëm dhe është përsëritur datë 3.9.2012.

Në këtë rast, nuk janë respektuar afatet e njoftimit në kundërshtim me kërkesat e nenit 43 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

I gjithë dokumentacioni i arkivuar, i subjektit fitues, është fotokopje e pa noterizuar, shkelje e kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 46, 53, 55 dhe VKM nr. 1, datë 10.1.2007 "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar dhe udhëzimit të APP-së për dokumentet që arkivohen.

-Për shkelje të rregullave të prokurimit publik, në tenderin me objekt: "Rikonstruksion i rrugëve rurale të komunës për vitin 2013", zhvilluar në vitin 2013.

Nuk janë respektuar afatet e njoftimit të tenderit. Njoftimi i publikuar në APP, është bërë në buletin e datës 15.4.2013, kurse tenderi është zhvilluar datë 16.4.2013.

Në arkivin elektronike, njoftimi i shpalljes së tenderit, është bërë datë 8.4.2013.

Në këtë rast, nuk janë respektuar afatet e njoftimit në kundërshtim me kërkesat e nenit 43 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Josif Lile, Përparim Gjuzi dhe Luan Kuka, më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Luljeta Nano, Sekretar i Përgjithshëm.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT